



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401696/5

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandim mbi dhënien e licensës së Përmbaruesit Gjqësor Privat, shtetasit F. B. nga Saranda.*

Drejtuar : **Zj. LLAMBRIOLA MISTO**
Sekretare e Përgjithshme
Ministria e Drejtësisë

TIRANË

E nderuar Zj.Misto,

Në ankesën e tij datë 29.09.2014 drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi F. B. nga qyteti i Sarandës është ankuar ndaj Ministrisë së Drejtësisë Tiranë, pasi deri me datën 06.05.2014, ai ka punuar si përmbarues gjyqësor në Zyrën Përmbarimore Sarandë, me qëllim që të marrë licencën për të punuar si Përmbarues Gjqësor Privat sipas kërkesave të ligjit.

Ankuesi F. B. pretendon se kërkesën e tij për dorëheqje të parevokueshme nga detyra e Përmbaruesit Gjqësor Shtetror e ka bërë bazuar në kërkesat e nenit 14 të Ligjit nr.10031 datë 11.12.2008 "Për shërbimin Përmbarimor Gjqësor Privat, i ndryshuar me Ligjin nr.36/2012 ku parashikohet shprehimisht se: ***"Përfundohen nga detyrimi për të dhënë provimin e kualifikimit personat që me datën 30.12.2011 kanë qënë në punë si Përmbarues Gjqësor Shtetror"***. Ankuesi pretendon gjithashtu se ka kërkuar informacion dhe përgjigje për zgjidhjen e këtij problemi nga Ministria e Drejtësisë dhe deri tani prej saj nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Duke analizuar në tërësi të gjitha provat shkresore të paraqitura nga ankuesi F. B. rezultoi se ai ka punuar si Përmbarues Gjqësor në Zyrën Përmbarimore Sarandë, nga data 31.03.2011 deri me datën 06.05.2014, dhe se në rastin konkret ai plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara nga nenit 14 i Ligjit të cituar më sipër.

Në rastin konkret çmohet që për zgjidhjen e këtij problemi nga ana jonë të ndërhyhet me anë të rekomandimit, kërkesë kjo e bazuar në kërkesat e nenit 63 pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: ***"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të Drejtave të Njeriut, nga administrata publike"***, dhe në nenin 21/b të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet se, pas përfundimit të hetimit : ***"Avokati i Popullit paraqet***

rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administratës, që sipas tij ka shkaktuar shkeljen e të drejtave dhe lirive”.

Për si më sipër Ju,

REKOMANDOJMË :

1.Të shikohet mundësia e paisjes menjherë me çertifikatën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, të shtetasit F. B.

2.Mbi qëndrimin e mbajtur në lidhje me këtë rekomandim bazuar në kërkesat e nenit 22 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, të njoftohemi brenda 30 ditëve.

Duke besuar në mirëkuptimindhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI